



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS ISTOG

Numri i lëndës: 2022:116879
Datë: 07.03.2024
Numri i dokumentit: 05422822

C.nr.242/22

GJYKATA THEMELORE NË PEJË- DEGA ISTOG, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni për Çështje Civile, me gjyqtaren Lirika Sylaj, në çështjen juridike kontestimore të paditëses A.S me vendbanim në fshatin D., Komuna e Istogut, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Florije Curri - Kryeziu avokate në Prishtinë, kundër të paditurës Komuna e Istogut - Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt të kontestit, kompensim mbi bazën e inflacionit, kualifikimit dhe kompenzimin e shpenzimeve të ushqimit – shujtave, jashtë seance gjyqësore me datë 07.03.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M
për shkak të pa dëgjueshmërisë – mosbindjes

I APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditëses A.S nga fshati D., Komuna e Istogut, ashtu që, DETYROHET e paditura Komuna e Istogut - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses t'ia kompensoj shumat si në vijim:

- në emër të diferencës së pagës për kualifikim shkollor – diplomë fakulteti (master), në lartësi 35% të pagës bazë, për periudhën nga data 18.04.2017 e deri me datën 20.01.2021, për gjithsej 45 muaj, duke e llogaritur nga 89.10 euro për secilin muaj, shumën e përgjithshme prej 4,009.5 Euro;
- në emër të kompensimit për ushqim gjatë punës - shujtave ditore për 253 ditë nga 2 (dy) euro për secilën ditë të prezencës në punë, shumën prej 506.00 Euro;
- në emër të kompensimit për inflacion për vitet 2019, 2020 dhe 2021, të ja paguaj shumën prej 342.69 euro, të gjitha këto në shumën e përgjithshme në lartësi prej 4,858.19 Euro me kamatë ligjore 8% në vit, nga data 03.06.2022, e deri në pagesën definitive të detyrimit, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm

II DETYROHET e paditura Komuna e Istogut - Drejtoria Komunale e Arsimit, t'ia paguaj paditëses shpenzimet e procedurale në shumë të përgjithshme prej 125 €, në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësja përmes përfaqësueses së autorizuar me padinë e datës 03.06.2022 si dhe precizimin e kërkesëpadisë së datës 24.02.2023 dhe 17.10.2023, ka kërkuar që të detyrohet e paditura Komuna e Istogut-Drejtoria Komunale e Arsimit, paditëses A.S t'ia kompensojë shumën në lartësi prej 4,009.5 €, në emër të kualifikimit për periudhën nga data 18.04.2017 e deri me datën 20.01.2021,

për gjithsej 45 muaj, në emër të shpenzimeve të udhimit shumën prej 506 euro si dhe në emër të inflacionit për vitet 2019, 2020 dhe 2021 shumën prej 342.69 euro, të gjitha këto në shumën e përgjithshme në lartësi prej 4,858.19 Euro me kamatë ligjore 8% në vit, duke e llogaritur nga data e hyrjes në fuqi të kontrates kolektive.

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore pas shqyrtimit paraprak të padisë ka nxjerrë aktvendimin për përgjigje në padi me datë 27.01.2023 të cilën e njëjta e ka pranuar me datën 31.01.2023 (*sipas fletëktheses në shkresat e lëndës*).

Me aktvendimin për përgjigje në padi, gjykata e ka njoftuar të paditurën për detyrimin ligjor për dhënie të përgjigjes në padi dhe për pasojat ligjore që do t'i ketë nëse nuk paraqet përgjigje në padi, gjegjësisht për mundësinë që gjykata të marrë aktgjykim për shkak të mosbindjes - pa dëgjueshmërisë.

E paditura, pavarësisht se e ka pranuar aktvendimin për përgjigje në padi, së bashku me padinë dhe provat materiale e po ashtu edhe parashtrësit mbi precizimin e kërkesëpadisë, në këtë çështje juridike kontestuese, nuk ka paraqitur përgjigje në padi brenda afatit ligjor.

Gjykata, pasi i ka vlerësuar kushtet ligjore për nxjerrjen e aktgjykimit për shkak të mosbindjes, ka gjetur së në rastin konkret plotësohen të gjitha kushtet ligjore për nxjerrjen e aktgjykimit në fjalë nga neni 150 paragrafi 1 pikat a), b) dhe (c) të LPK-së, nëse të paditurit i është dorëzuar padia dhe thirrja për përgjigje në padi, se themelësia e kërkesëpadisë del nga faktet e treguara në padi dhe se faktet në të cilat mbështetet kërkesëpadia nuk janë në kundërshtim me provat që i ka propozuar vetë paditësi apo me faktet e ditura botërisht.

Themelësia e kërkesëpadisë del nga provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, dhe atë nga kontrata me numër 1172/13 e datës 11.10.2013 e lidhur në mes të paditurës dhe këtu paditëses nga të cilat vërtetohet se paditësja është në marrëdhënie pune te e paditura në Sh.f.m.u "Fan.S.Noli" në Llukac të Begut, nga vërtetimet nr.369/22 i datës 31.03.2022 dhe ai me nr.486/23 i datës 25.01.2023 vërtetohet vijueshmëria në punë e paditëses nga data 27.09.2021 e deri me datën 16.11.2022 për periudhën për të cilën e njëjta kërkon kompensimin, diploma me NR.411 e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" e datës 27.04.2011 për njohjen e titullit "Bachelor i programit fillor" si dhe diploma me NR.805 e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" e datës 06.02.2017 për njohjen e titullit "Master i Pedagogjisë" Drejtimi Pedagogji e përgjithshme si dhe lista e pagave nga e cila vërtetohet paga bazë e paditëses.

Në rastin konkret, gjykata gjeti se e paditura ka për detyrim, që paditëses t'i paguajë kompensimin mbi bazën e kualifikimit, konform detyrimeve që rrjedhin nga Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, datë 29.08.2008 (i shfuqizuar me Ligjin për Pagat në Sektorin Publik, Nr.08/L-196), ku është përcaktuar se të gjithë mësimdhënësit do të kenë rritje të pagave të tyre në bazë të kriterëve të licencimit, pra mësimdhënësve, drejtorëve, zëvendësdrejtorëve dhe bashkëpuntorëve profesional, përfitojnë rritje page me diplomë të shkollës normale 10 % të pagës bazë, me diplomë të shkollës pedagogjike me nje ngritje te pagës bazë prej 19%, me diplome universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27% dhe me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktoraturë) përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 35 %. Zbatimi i këtij vendimi të Qeverisë, rastet e kualifikimit-licencimit është në përputhje edhe me Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, nr.214/2023 të datës 05.10.2023. Nga shkresat e lëndës u vërtetua se se e paditura, paditëses A.S i'a ka paguar

pjesërisht shumë prej 58.32 Euro, duke mos e përmbushur detyrimin për pjesën tjetër të mbetur në vlerë prej 89.10 Euro për gjithsej 45 muaj, për periudhën sa ka qenë në fuqi kontrata kolektive.

Po ashtu, gjykata ka vendosur ta aprovojë kërkesëpadinë e paditëses, që të ia kompensoj diferencën e pa paguar në pagë, referuar normës së inflacionit për vitin 2019 – 2,7 %, për vitin 2020 – 0,2 %, për vitin 2021 – 3,4% duke u bazuar në dispozitat e nenit 35, pika 10 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017 si dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 22.01.2021, që parashihet se *“Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit në bazë të Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës”*.

Sa i përket shkallës së inflacionit nëpër vite, gjykata vendosi si më lartë duke u bazuar konform tabelës së inflacionit të lëshuar nga parashtrësja e Agjencionit të Statistikave të Kosovës, me numër 01-02-1436, të datës 27.10.2023.

Gjykata është bazuar në mendimin juridik të miratuar në Seancën e Përgjithshme të Gjykatës Supreme, të datës 09 tetor 2023 në cilin parashihet se *“Punëtorët në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017 dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021, kanë të drejtë që në pagën e tyre të futet përqindja e inflacionit, marrë për bazë shkallën e inflacionit çdo vit Sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës”*, ashtu siç është përcaktuar me nenin 35, pika 10 të këtyre marrëveshjeve”.

Gjykata përveç kërkesës kryesore në dispozitivin I të këtij aktgjykimi, ka vendosur edhe për kamatën ligjore, duke u mbështetur në dispozitën e nenit 382 të LMD-së dhe Mendimit Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës për nr.265/2020 të datës 01.12.2020, ashtu që ka marr datën e ushtrimit të padisë (data 03.06.2022), e ku lartësia e kamatës vjetor është e definuar 8% deri në pagesën definitive.

Vendimin që pala e paditur ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449 dhe 452 të LPK-së, ndërsa sa i përket lartësisë së shpenzimeve të procedurës u bazua në nr. tarifor 6 të Rregullorës për Tarifën e Avokatëve të Kosovës ashtu që lartësia e shpenzimeve të aprovuara i referohet 104 euro për përpilim të padisë dhe 21 euro për taksë gjyqësore.

Gjykata, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke i'u referuar dispozitës së nenit 150 par.1 pika a, b, dhe c të LPK-së, e në lidhje më dispozitat e nenit 35 par.7, 10, të Kontratës Kolektive të Arsimit të datës 18.04.2017 dhe të daës 22.01.2021 dhe dispozitave të nenit 245 par.1 dhe 2, neni 249 par.1 dhe 2 të LMD-së.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË- DEGA ISTOG,
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni për Çështje Civile
C.nr.242/22 data 07.03.2024

Gj y q t a r j a
Lirika Sylaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit, nëpërmjet të kësaj Gjykatë.